



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 18, datë 07.10.2021

MBI

**“MIRATIMIN E RREGULLORES TË FUNKSIONIMIT TË REKTORATIT NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”, pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores të funksionimit të Rektoratit në UART, përcjellë nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Rektorit me nr. 147, datë 15.09.2021, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores të funksionimit të Rektoratit në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Prof. Asoc. Dorian ÇENE**

**Prof. Gazmend GJOKA**

**Prof. Asoc. Kastriot TUSHA**

**Prof. Dr. Erald BAKALLI**

**Prof. Endri SINA**

**Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI**

**Prof. Asoc. Albes FUSHA**

**Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI**

**Dea SHUBLEKA (Studente FAB)**

**Sindi ZDRAVA (Studente FM)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE



## RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË REKTORATIT

*Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 18 datë 07/10/2021*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË REKTORATIT

### Neni 1

#### Baza Ligjore e Rregullores

1. Rregullorja e funksionimit të Rektoratit të Universitetit të Arteve, (në vazhdim UART) është mbështetur në:
  - a) Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” Kreu i V-të, Neni 40 “Rektorati”;
  - b) Statutin e Universitetit të Arteve Neni 29 “Rektorati”;
  - c) Kodin e Etikës së Universitetit të Arteve;
  - d) Rregulloren e Universitetit të Arteve.

### Neni 2

#### Objekti i Rregullores

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe standardeve për mënyrën e funksionimit të Rektoratit të UART, lidhur me problematikat që analizon dhe vendimet që merr.

### Neni 3

#### Përbërja e Rektoratit

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe ka në përbërje të tij:
  - a) Rektori;
  - b) Zëvendës rektorët e UART;
  - c) Drejtuesit e njësive kryesore të UART;
  - d) Administratorin e UART;
2. Në mbledhjen e rektoratit, sipas nevojës, mund të ftohen edhe funksionarë të tjerë të Universitetit të Arteve dhe/apo të njësive të tjera.

### Neni 4

#### Veprimtaria e Rektoratit

1. Rektorati i UART”, e ushtron veprimtarinë e tij përmes veprimtarisë së fakulteteve, departamenteve, njësive dhe komisioneve të përhershme të përcaktuara në Statutin e UART.
2. Llojet e njësive, komisioneve edhe fokusi i veprimtarisë së tyre përcaktohen në Statutin e UART.
3. Rektorati ushtron këto kompetenca:
  - a) harton planin strategjik të zhvillimit të Universitetit mbi bazën e propozimeve të njësive bazë dhe ato kryesore;
  - b) propozon hapjen, mbylljen apo riorganizimin e njësive kryesore dhe njësive të tjera të veçanta;
  - c) jep mendim për tematika dhe probleme, të cilat prekin funksionimin dhe autonominë e Universitetit të Arteve;







- d) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
- e) përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njëjësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
- f) paraqet rekomandime në Senat mbi strukturën e përgjithshme organike dhe analitike si dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
- g) paraqet në Senat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore artistike/shkencore;
- h) paraqet rekomandime në Senat mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare/ndërkombëtare;
- i) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik;
- j) paraqet në senat kodin e etikës;
- k) harton dhe paraqet për miratim rregulloren e Universitetit të Arteve;
- l) trajton dhe merr vendim për ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve;
- m) trajton dhe zgjidh mosmarrëveshjet mes drejtuesve të njëjësive kryesore;
- n) ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në statut dhe akte të tjera të Universitetit.

#### Neni 5

#### Përgatitja e Mbledhjeve të Rektoratit

1. Rektorati mbledhet rregullisht, çdo javë, por në çdo rast, sipas tematikës, jo më pak se dy herë në muaj.
2. Mbledhja e Rektoratit thirret nga Rektori, ose të paktën një e treta e anëtarëve të tij.
3. Për çdo problematikë që është objekt diskutimi në Rektorat dhe që lidhet me veprimtarinë e një Komisioni të caktuar, është detyrim i Rektorit që të verë në lëvizje Zëvendës rektorin dhe Komisionin përkatës.
4. Opinioni i anëtarëve të Komisionit përkatës prezantohet para Rektoratit nga kryetari i tij, përmes një relacioni me shkrim, ku pasqyrohen qëndrimet e të gjithë anëtarëve të komisionit.
5. Për problematika që janë objekt diskutimi të Rektoratit dhe që nuk lidhen me veprimtarinë e ndonjë Komisioni të caktuar, është detyrim i Rektorit/Zv. Rektorit sipas fushës që ai mbulon, që të prezantojë problematikën për të cilën rektorati mbledhet.
6. Për çdo mbledhje të Rektoratit mbahet procesverbal.
7. Rektorati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.

#### Neni 6

#### Zhvillimi i Mbledhjeve të Rektoratit

1. Mbledhjet e Rektoratit drejtohen nga Kryetari i tij (Rektori).
2. Mbledhjet e Rektoratit zhvillohen sipas një rendi dite të përcaktuar.
3. Rendi i ditës ju bëhet me dije anëtarëve të Rektoratit 2-3 ditë para zhvillimit të mbledhjes.
4. Mbledhjet e Rektoratit zhvillohen sipas rendit kronologjik si më poshtë:  
Rektori:
  - a) çel mbledhjen dhe prezanton rendin e ditës;
  - b) prezanton problematikën dhe fton anëtarët e Rektoratit të bëjnë pyetje;





- c) fton anëtarët e Rektoratit në diskutime rreth problematikës;
  - d) fton kryetarin e komisionit përkatës që të shprehet me shkrim në emër të komisionit;
  - e) bën konkluzionet e diskutimeve;
  - f) prezanton projektvendimin përkatës/planin e masave dhe e mbron atë;
  - g) hap votimin e projektvendimit/planit të masave;
  - h) vijon me rendin e ditës;
  - i) Në rendin e ditës të çdo mbledhjeje duhet të ketë një pikë të fundit “Të tjera” që i kushtohet prezantimit të shqetësimeve që kanë fakultetet por dhe ato që ka Rektorati.
5. Në diskutimin e një problematike anëtari i Rektoratit ka të drejtë të angazhohet të paktën një herë gjatë saj për të bërë pyetje dhe një herë për diskutim.

#### **Neni 7 Votimi në Rektorat**

1. Vendimet në mbledhjen e Rektoratit merren me shumicë të thjeshtë të votave të të pranishmëve në mbledhje.
2. Në rast se votat pro dhe kundër, për një çështje të caktuar, janë në numër të barabartë, vendimtare është vota e Rektorit.

#### **Neni 8 Dokumentacioni i Mbledhjes**

1. Për mbledhjet e zhvilluara, asistentja e Rektorit të UART përgatit dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshihen:
  - a) Rendi i ditës;
  - b) Lista e anëtarëve të Rektoratit që janë të pranishëm;
  - c) Materiali i përdorur si bazë për diskutim dhe vendimmarrje, projektvendimi/planin e masave, etj.;
  - d) Vendimet e marra;
  - e) Procesverbalin e regjistrimit të pyetjeve dhe diskutimeve.
2. Këto dokumente nënshkruhen nga asistentja e Rektorit & Rektori.

#### **Neni 9 Ndryshimi i Rregullores**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në përputhje me përcaktimet në Statutin e UART.

#### **Neni 10 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik të UART.

